



## Momentet Kyçe të Vitit

### NGRITJA E QENDRES & PROGRAMI

Nga një ambient i boshatisur 250 m<sup>2</sup>, gjatë 3 muajve të parë të 2020, ngritëm Qendrën Multifunktionale H.A.N.A, të pajisur me 6 kënde shërbimi për të rinjtë Lezhjanë. Inaugurimi publik u krye në Qershor të këtij viti.

### TREGIMTARI & MULTIMEDIA

Në Korrik, lançuan një kurs për qytetarë gazetarë mes të rinjve Lezhjanë. Gazetarë dhe aktivistë të shquar të shoqërisë civile u rekrutuan si udhëheqës sesionesh. Mentori kryesor i kursantëve të rinj ishte Aleksandër Çipa.

### FUSHATA E AKTIVIZMIT GJINOR

Qendra H.A.N.A u bë pjesë e agjendës së 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore. Pavarësisht vështirësive, u konceptuan 2 aktiviteteve; teatri social "Ri-Edukimi i Apollonit" dhe punimi video "Vajzat Munden"

## LABORATORI KRIJUES I H.A.N.A

Titulli i referohet një grupimi aktiviteteve në Këndin Social të Qendrës. Aktivitete si, shfaqje filmash/dokumentarësh, ekspertë të ndryshëm të ftuar për të bashkë-ndarë me të rinjtë ide dhe koncepte, aktivitete sociale, kulturore dhe argëtuese si promovim doku-filmi, gjueti thesari, pasdite poezie dhe muzike etj. Mbi 150 të rinj u bënë pjesë e ketyre eventeve.

## BASHKEPUNIMET DHE PLANET E REJA


Programi i Qendrës gjatë 2020 është mbështetur nga European Endowment for Democracy. Në kuadër të këtij programi, janë nënshkruar marrëveshje me Zyrën Vendore Arsimore, DRSHTSH Lezhë, 2 fakultete, 2 shkolla si dhe është hartuar në dakortësim reciprok marrëveshja afat-gjatë me Bashkinë Lezhë. Qendra ka aplikuar për të zgjeruar portofolin e saj me projekte të reja gjatë 2021 dhe ka mundur të sigurojë bashkëpunim me Ministrinë për Çështjet e Jashtme dhe Evropiane të Luksemburgut dhe LEVIZ Albania.




Supported by

EUROPEAN  
ENDOWMENT FOR  
DEMOCRACY

H.A.N.A  
HAND TO HAND  
AGAINST  
NATION  
APATHY



JANAR 2020



MARS 2020



## NGRITJA E QENDRES

H.A.N.A është një organizatë e llojit Qendër dhe si e tillë kishte nevojë për ambiente që të pëmbushnin premtimin e statusit ligjor të saj. Kështu, gjatë 3 muajve të parë të vitit është punuar intensivisht për të kthyer hapësirën boshe ku zëri jehonte në eko kumbuese, në një njësi funksionale shërbimesh rinore.

Konceptimi i këndeve dhe i arredimit është kryer nga stafi i Qendrës. Pajisja dhe prokurimi i materialeve të nevojitura është mundësuar falë mbështetjes programatike nga European Endowment for Democracy.

Kështu, në Qendër u ngriten 6 këndet e shërbimit dhe funksionimit siç vijon; këndi i tryezës së rrumbullakët, këndi i multimedias, këndi i zyrës, këndi i punishtes, këndi social, dhe bar-bufe me vetë-shërbim.

## REFLEKTIME

Ky është buletini i parë i lëshuar nga organizata jonë për të reflektuar mbi momentet e kaluara dhe progresin drejt misionit tonë gjatë një viti të gjatë e intens. Që prej Janarit e gjër sot, bashkuam një buqetë momentesh për ti ndarë me audiencën tonë, me shpresën që të zgjerojmë të kuptuarin rreth programit të Qendrës dhe kontributit tonë për komunitetin Lezhjan, sigurisht, për të rinjtë së pari!

Herët gjatë udhëtimit tonë, kuptuam se mënyra e duhur për të bërë përpjekjet tona të vlefshme, është ndikimi pozitiv në sistemin e vlerave të të rinjve tanë. Ndjenjat e krijimtarisë, vetëdijes, ndjeshmërisë, tolerancës, kuriozitetit dhe sportivitetit janë ato që ne kërkojmë të nxisim tek frekuentuesit tanë! Ende nuk i kemi arritur të gjitha këto, por kemi bërë një progres të dukshëm.


Nga ftesa për t'ju bashkuar kursit tonë të gazetarisë qytetare, tek eventet e shumta artistike e kulturore, tek nismat në terren e deri tek bisedat që sfidojnë stereotipet sociale e mungesën e informacionit, ne arritëm të tërheqim vëmendjen e tyre. Për këtë, sigurisht që patëm ndihmë; European Development for Democracy i dha kuptim përpjekjeve tona përmes besimit e burimeve financiare të investuara në programin tonë! Kjo është gjithçka që na duhej për të përmbyllur një vit të mrekullueshëm me një ide të bërë realitet: qendra e parë rinore shumë-funksionale në Lezhë!

## PROGRAMI I QENDRES

H.A.N.A ka konsoliduar një program dhe portofol projektesh gjatë vitit 2020. Ky program përbehet nga komponentët në vijim;

- 1) Tregimtari & Multimedia (kursi për qytetarin gazetar; rubrika e heronjve lokalë dhe eksperimentet sociale)
- 2) Praktika Studentore (ndërmjetesimi i praktikave universitare të studentëve në institucione të ndryshme të Lezhës)
- 3) Orët e Shërbimit Komunitar (riciklimi dhe ndërgjegjësimi për mjedisin; teatri social, gazetaria qytetare në veprim)
- 4) Laboratori Krijues (pasditet e filmit/dokumentarit; eventet social-kulturore)
- 5) Edukim politik dhe civik (klubi "Bëhu Burrë; kurse te shkurtra në politikë dhe integrim Evropian kombinuar me vizita shkëmbimore dhe debate të strukturuar)





## TREGIMTARI & MULTIMEDIA

Kursi 5-mujor (Korrik-Dhjetor 2020) për të kthyer të rinjtë në gazetarë qytetarë, ka qënë një ndër arritjet kryesore të vitit për Qendrën. Kurrikula e kursit është ngritur nga ekspertë të fushës së medias dhe aktivizmit qytetar, kyesuar nga Aleksandër Çipa, duke trajtuar tema si; komunikimi; dizinformimi, misinformimi, malinformimi; teknologjia dhe transmetimi radiofonik; podcasti dhe marketingu digjital; aktivizmi përmes medias sociale; referencat; shkrimi i artikujve informues/investigative; aktivizmi përmes rrjeteve sociale etj.

Është zgjedhur kjo tematikë për tu trajtuar me 15 të rinjtë frekuentues pasi kemi dashur që ata të mësojnë të përdorin efektivisht mjetet online/offline për të ngritur zërin për kauza që i shqetësojnë.

Pesha e fjalës dhe mundësia e mediatizimit të saj sot përbëjnë një forcë të madhe ndikimi dhe historitë rrisin nivelin e empatisë dhe ngacmojnë imagjinatën. Kështu, ata kanë mësuar të ecin "në këpucet" e dikujt tjetër; të dëgjojnë, hulumtojnë e kuptojnë më shumë! Produkte direkte të kursit kanë qënë artikujt me natyrë hulumtuese, informuese e ilustruese të të rinjve si dhe një media sociale e re në rrjetin social Facebook e quajtur "Projekti Im"; faqe online e pasuruar me shkrimet e natyrës raportuese, informuese dhe investiguese nga kursantët aktualë e të ardhshëm të Qendrës.



## DHUNA ME BAZE GJINORE

11 prej aktiviteteve që kanë mbushur programin tonë gjatë vitit 2020, i janë dedikuar luftës ndaj mendësisë së dhunës, shpalosur veçanërisht në trajtën e dhunës me bazë gjinore, me viktimë, në rastet dërrmuese, vajzen dhe gruan. Kështu, Qendra u angazhua në konceptimin dhe realizimin e 4 punimeve videografike, ndër të cilat 2 eksperimente sociale. Këto 2 punime kanë trajtuar këndvështrimet e të rinjve dhe fëmijëve rreth dhunës dhe trajtimit të pa-barabartë të vajzës/gruas në shoqërinë Shqiptare. 2 punimet e tjera kanë ilustruar përgjigjen e institucioneve përgjegjëse për trajtimin e dhunës, si dhe atë komunitar mbi rolin e policisë në komunitetet e tyre.

Përpos videografisë, një metodologji tjetër e përdorur për trajtimin e fenomenit ishte analiza e koncepteve që i përkasin dhunës me bazë gjinore me grupe të rinjsh me ndihmën e ekspertëve ligjorë e punonjësve social. Qendra realizoi një analizë studimore bazuar në opinionin me shkrim të 118 të rinjve rreth perceptimeve mbi barazinë gjinore që nxorri në pah probleme të theksuara me të kuptuarin e tyre dhe nevojën për përfshirje imediate në programe ndërgjegjësimi si dhe rolin e shtuar të punonjësve socialë dhe psikologëve në shkolla.

2 debate të strukturuar sollën të rinjtë në panele argumentimi përballë njëri tjetrit dhe një jurie profesionale për të konsoliduar të njohuritë e marra nga sesionet me stafin e Qendrës dhe specialistët.

Përpjekjet më lart, u ndërthurën edhe me aktivitete të një natyre kulturore e artistike si një instrument i konsideruar i vlefshëm për të apeluar ndaj fenomenit. Kështu, përmes artit të bukur të teatrit social si dhe shprehisë poetike e tingujve muzikorë, u jetëzua shfaqja "Ri-Edukimi i Apolonit me udhëheqës Vladimir Doda si dhe pasditja "Oda e Poezisë" nga Jerida Sakaj & miqtë.



## KLUBI "BEHU BURRE"

Jetojmë në një shoqëri ku patriarkati apo e drejta e burrave për të vendosur, ka qënë dominuese prej shekujsh e vijon të jetë në fragmente të ndryshme të shoqërisë Shqiptare, veçanërisht në zona rurale, të Lezhës gjithashtu. Kjo ka ushtruar trysni të pamërituar ndër djemtë e rinj si dhe ka privuar vajzat nga perspektiva për fuqizim e barazi. Jemi përballur gjatë vitit 2020 me realitetin e ndikimit të patriarkatit tek të rinjtë që kanë frekuentuar qendrën. Interesi i ulët i djemve për të marrë pjesë e për t'u angazhuar si dhe tendenca për të artikuluar më me vështirësi benefitet e pjesëmarrjes në programe aktivizmi për drejtësi sociale në krahasim me vajzat, është tregues i normave të imponuara nga shoqëria për tu dukur të fortë, fjalë-pak e për të maskuar emocionet me stoicizëm.

H.A.N.A e ka "veshur" programin e saj në mënyrë të qëllim të evente që kanë synuar të sulmojnë këtë sistem vlerash të ngurta e dëmtuese. Në 3 muaj, pilotuam klubet rinore "Bëhu Burrë", pjesë e manualit "Programi Y - Rinia" - produkt i "Young Men Initiative" ndërmarrë nga Care International dhe partnerët në Ballkan dhe adaptuar në Shqipëri nga Qendra "Act for Society".

Sesioni I i trajtuar, "Qëndrimet Gjimore" synoi të nxisë reflektim kritik të normave gjimore që nxisin dhunën dhe sjellje tjera jo të shëndetshme tek të rinjtë. U sfiduan stereotipet gjimore për 36 të rinjtë e përfshirë duke i sfiduar ta shohin botën nga perspektiva e gjinisë së kundërt. Ata janë ushtruar në shprehjen e emocioneve dhe kanë reflektuar për gjërat që duan në jetë dhe si zgjedhjet e tyre ndonjëherë kufizohen për shkak të paragjytimeve që shoqëria promovon.

## LABORATORI KRIJUES

Përgjatë një viti me sfida monumentale, përfshirë një tërmet shkatërrues, një pandemi sflitëse, një numër trazirash social-politike dhe alarmin e një rinie të etur për arrati, Qendra H.A.N.A është përpjekur të ofrojë një programacion dinamik për të treguar se ka edhe mundësi mes sfidash. Laboratori Krijues është një fraksion i programit të H.A.N.A dedikuar kohës me të rinjtë në nisma social-kulturore dhe të ndërgjegjësimit civik. Nga 80 ndërhyrjet e realizuara gjatë vitit, në forma e trajta të ndryshme, 28 kanë qënë nën këtë rubrikë. Këndi i filmit ka bërë bashkë 33 të rinj në kohëra të ndryshme. Takimet me ekspertë të fushave të ndryshme por nën çadrën e qytetarisë aktive dhe një rinie të informuar e aktive në çështje të interesit publik, kanë përbërë 36% të eventeve. Eventet social-kulturore të kryesuara nga pasditet e poezisë, gjuetia e thesarit, promovimi i arritjeve të të rinjve Lezhjanë kanë zënë 64% të rubrikës dhe plot 58 të rinj të moshave 12-32 janë bërë pjesë në mënyra të ndryshme. Ndër takimet që kanë lënë më shumë mbresa mund të përmendet promovimi i doku-filmit "Neverland" realizuar në Lezhë dhe marrës i disa çmimeve ndërkombëtare; Oda e Poezisë nën udhëheqjen e Jerida Sakaj; Dita e Rinisë 12 Gusht me një agjendë të ngjeshur me aktivitete argëtuese, përfshirë gjueti thesari nëpër Lezhë: Provat për ngritjen e shfaqjes "Ri-Edukimi i Apolonit" si dhe realizimi i një eksperimenti social të titulluar "Vajzat Munden".





## 16 DITET E AKTIVIZMIT GJINOR

25 Nëntor - 10 Dhjetor, përfaqësojnë 16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Qendra H.A.N.A i është bashkuar kësaj fushate përmes kontributit në hartimin e agjendës lokale në kuadër të këtij eventi duke e pasuruar atë me 2 evente; një shfaqje teatrale dhe një video ndërgjegjësuese mbi një prej formave të pabarazisë gjinore.

Qendra bashkëpunoi me një profesionist në fushën e teatrit i cili udhëhoqi të rinjtë në ngritjen e shfaqjes teatrale "Ri-Edukimi i Apolonit". Shfaqja trajton dhunën ndaj grave të manifestuar përmes ngjarjeve brutale të ndodhura në Shqipëri. Shfaqja nuk u arrit të vihej në skenë për shkak të rrethanave kufizuese të COVID-19, megjithatë u realizuan 2 video promovuese dhe të rinjtë mundën ta vënë në skenë sapo të lehtësohet situata.

Produkti i dytë i ideuar e zbatuar nga Qendra H.A.N.A në kuadër të fushatës ishte një video në trajtë eksperimenti social. Punimi u quajt "Vajzat Munden" dhe synoi të sfidojë stereotipitë gjinore të lidhura me disa poste të konsideruara tradiconalisht si "burrërore". Eksperimenti konsistoi në 5 fëmijë të moshave 7-9 vjeç përballë 5 personazheve përfaqësuese të roleve të konsideruara nga shoqëria si të lidhura me figurën e burrit. Punimet e fushatës gjëndën në faqen You Tube të Qendrës H.A.N.A



Dhjetor 2020

## EDUKIMI CIVIK & POLITIK


Një ndër nxitësit kryesorë të krijimit të Qendrës Rinore H.A.N.A ishte paretaria ndaj qëndrimit indiferent të njerëzve, rinisë veçanërisht, ndaj problemeve të panumërta të shoqërisë Shqiptare në zhvillim e sipër.

Kështu, Qendra, përmes Këndit Social, ka organizuar ndërhyrje për të informuar, ndërgjegjësuar e aktivizuar të rinjtë frekuentues ndaj disa çështjeve me rëndësi publike. Në Qershor, vendi u trondit nga përdhunimi i një vajze të re dhe Qendra arriti të organizojë Shoqërinë Civile të Lezhës në një manifestim për ti thënë jo pedofilisë, përdhunimit dhe ngacmimeve seksuale.

Një ndër çështjet me rëndësi për programin e Qendrës, është ajo e respektit për mjedisin dhe parimi i riciklimit. Të rinjtë e Qendrës kanë vizituar thujse për një javë resht në Gusht lokale të ndryshme në Lezhë e Shëngjin për të mbledhur shishet plastike të boshatisura një përdorimshe. Më pas, në Punishten e qendrës kanë modeluar kosha mbeturinash me këto shishe, tel, hekur e spango lini. Koshat e prodhuar nga qendra ju dhuruan Bashkisë Lezhë dhe pushuesve të bregdetit të Shëngjinit.

Gjatë muajve Shtator e Tetor, Qendra mundësoi një sërë takimesh për frekuentuesit e saj për të analizuar ligjin e ri të rinisë; buxhetin bashkiak si dhe njohur e diskutuar me avokatin e zonës për të përforcuar nevojën e përfaqësuesve të popullit për llogaridhënie. Gjithashtu, me rëndësi për Qendrën është edhe trajtimi i historive të intelektualëve të vrarë nga diktatura Shqiptare, audienca e re e Qendrës, është njohur me 5 figura të tilla gjatë vitit.

Botimi I



## VIDEO PUNIMET E H.A.N.A

Njëri prej pasioneve të Qendrës tonë është dokumentimi i copëzave të realitetit përmes lenteve të kamerave.

Video-grafia si një menyrë tregimi historish ka zënë një pjesë të mirë të kohës tonë. 16 projekte të vogla në video janë konceptuar, realizuar dhe shpërndarë në kanalet virtuale të H.A.N.A.

Të gjitha punimet mund të gjenden në kanalën YouTube HANA Centre dhe variojnë në natyrë në kategoritë vjuese; 6 ndërjegjësuere rreth dhunës me bazë gjinore dhe asaj familjare, 5 pomovime të rinjsh në rubrikën "Heronjtë Lokale", 3 klipe ilustruese të benefiteve të pjesëmarrjes në programin e Qendrës për të rinjtë, 1 video-mesazh urimi për festat e fund-vitit dhe 1 ilustrim i rutinës së një studenti në karantinë.

Një instrument të tillë për transmetimin e mesazheve dhe emocioneve, po përpiqemi fort ta tejmë tek frekuentuesit tanë të "Tregimtari & Multimedia", në mënyrë që kursantët të kanalizojnë kreativitetin e tyre edhe në këtë formë!

## EVENTE SOCIAL-KULTURORE

Një qendër rinore nuk do të quhej e tillë nëse nuk do të lejonte/krijonte hapësirë për argëtim e mbledhje sociale. H.A.N.A është siguruar që të përmbushë këtë objektiv për të rinjtë pjesëmarrës. Meqënëse, pandemia e bëri të vështirë lejimin e grumbullimeve të mëdha, programacioni i Qendrës nuk është zbatuar dot në kapacitetet e plota dhe të synuara. Sidoqoftë, 10 aktivitete janë realizuar nën këtë kategori, duke lejuar që të rinjtë të kalonin një kohë cilësore me njëri-tjetrin

Eventi çelës i kësaj rubrike ka qënë inaugurimi i Qendrës, event i cili është udhëhequr më së shumti nga të rinjtë duke qënë se ambienti është modeluar sipas nevojave të tyre. Këndi Social ka mikpritur Pasditen e Filmit përmes shfaqjes së 3 filmave, 1 doku-filmi dhe 1 dokumentari; evente të cilat kanë shërbyer si katalizator i diskutimeve mes shikuesve rreth temave të trajtuara.

Dita e Rinisë, 12 Gusht 2020, është festuar si asnjëherë më parë në Lezhë; përmes një agjende të konceptuar për të stimuluar kreativitetin dhe kureshtjen e pjesëmarrësve. Përmes një gjuetie thesari me vendodhje të fshehta që zbuloheshin me deshifrimin e gjëgjëzave të fshehura nëpër qytet; eksplorimit të opsioneve për argëtim e sporte të brendshme në Qendër si lojëra tavoline, ping pong e lojëra inteligjence e deri te sesionet e kërcimit të sinkronizuar, dita u mbyll me të qeshura e kureshtjen e zgjuar për të frekuentuar Qendrën në vijimësi.

Qendra ka gjykuar se arti dhe "artvizmi" është një prej mënyrave për të adresuar çështje të lidhura me drejtësinë sociale, Qendra ka moderuar 2 evente poezie e kënge për të kanalizuar thirrje për një shoqëri tolerance e të ndjeshme ndaj artit e kulturës.

Në total, 86 pjesëmarrës, 93% e tyre të moshës 12-32 vjeç kanë marrë pjesë në këto evente.




# BASHKËPUNIMET DHE PLANET REJA

Gjatë 12 muajve të vitit 2020, Qendra H.A.N.A ka dakortësuar e finalizuar 10 marrëveshje ndër të cilat 5 me aktorë vendorë (Bashkia, ZVA, DRSHSSH, Gjimnazi Hydajet Lezha, Lezha Academic Center) për zbatimin e suksesshëm të programit të saj të planifikuar në muajt e vitet në vazhdim, 2 me palë kombëtare (Fakulteti i Ekonomisë Shkodër, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Tiranë) për të njëjtën arsye.

Qendra H.A.N.A ka synuar vazhdimisht zgjerimin e portofolit të projekteve dhe konsolidimit të programit të saj përmes identifikimit të strukturave e agjensive mbështetëse vendase e të huaja.

Falë ndërmjetësimit të donatorit të qendrës, EED, është mundësuar prezantimi dhe eventualisht, dakortësimi në marrëveshje mes Qendrës dhe Ministrisë së Çështjeve të Jashtme dhe Evropiane të Luksemburgut për zbatimin e shkollës dimërore "Hyrje në Politikë dhe Integrimi Evropian".

Gjithashtu, Qendra ka aplikuar me sukses pranë programit LEVIZ Albania dhe përgjatë gjithë vitit 2021, do të zbatojë projektin e titulluar "Rini, Respekt, Riciklim - Ekosistemi i Dashurisë për Mjedisin".



## FALENDERIME

Viti 2020 ka qënë ndërthurja e habitshme mes sfidave të pa-imagjinueshme por edhe mundësive jetëndryshuese për Qendrën H.A.N.A dhe themeluesit e saj! Viti i cili përmbysi realitetet një herë e përgjithmonë, duke lejuar vizionin që të trajtësohet në mes të një pandemie globale.

Në Janar 2020, nisi udhën marrëveshja e Qendrës me European Endowment for Democracy për mundësinë e shumë-pritur të ngritjes së një qendre funksionale rinore në Lezhë. Jemi mirënjohës përtej fjalëve të shkruara, për mundësinë e një jete! Ngritja e qendrës dhe buxhetimi i programit të saj nuk ishte e vetmja dhuratë nga EED. Mundësia e pjesëmarrjes së drejtuesit ekzekutiv të saj në kursin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve organizuar nga Kampusi Global i Venecias për të Drejtat e Njeriut si dhe ndërlidhja e pabesueshme me Qeverinë e Dukës së Madh të Luksemburgut, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane, për zbatimin e një shkolle dimërore për të rinjtë në politikë dhe integrimin Evropian, janë 2 arsyet e tjera pse jemi mirënjohës e falenderues për vitin e lënë pas.

Dinamizmi i vitit na ka vënë përballë përgjegjësisë për tu përballur me objektiva madhore e për tu rritur profesionalisht e qënë në lartësinë e pritshmërive ndaj nesh!

**INVESTIMI I BESIMIT ËSHTË FORMA MË EFIKASE E NXITJES SË PRODUKTIVITETIT NJERËZOR. KUSH DO TË ISHIM NËSE NUK DO TË NDJENIM DETYRIMIN E SHLYERJES SË BESIMIT TË INVESTUAR NË NE!**

Falenderimet tona nuk kursehen për bashkëpunëtorët lokalë e kombëtarë, të cilët panë një partner të besueshem tek ne dhe lejuan që të ndërthurim programet e agjendat; Bashkia Lezhë, Zyra Vendore e Arsimit Lezhë. Drejtorja Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Gjimnazi Publik "Hydajet Lezha", Shkolla Jo-Publike "Lezha Academic Center", Fakulteti Ekonomik Shkodër dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Tiranë!

Së fundmi, janë ata, rinia e talentuar dhe shpresë-dhënese Lezhjane që i dha jetë projektit tonë të Qendrës Rinore. H.A.N.A u krijua për të qënë e tyrja.

Faleminderit kujtdo që besoi tek ne dhe na shtriu dorën e solidaritetit gjatë 2020! Për shumë arsye, vitit që nuk do të hiqet kurrë nga memoria jonë kolektive!